



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

## FORUM I HAPUR

« *Promovim i vlerave të integritetit me të rinjtë* »

*Vendi i realizimit të eventit: Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës*

*Data: 12 Dhjetor 2022*

*Ora: 09:30-12:30*

### Program i aktivitetit

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është duke zbatuar projektin “**Thyerja e mitit të mosndëshkimit të korrupsionit duke forcuar besimin e qytetarëve tek institucionet e drejtësisë**”, mbështetur financiarisht nga Ambasada Amerikane në Tiranë.

Reforma në Drejtësi dhe zbatimi i saj ka qënë një nga zhvillimet më të rëndësishme të vendit tonë, si dhe një nga hapat kryesorë në rrugëtimin e Shqipërisë për Integrim në Bashkimin Europian. Zbatimi i kësaj reforme u ndërmor me qëllim promovimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Komiteti Shqiptar i Helsinkit beson se promovimi i vlerave të integritetit është një nga faktorët kyç që rrit besimin e publikut në reformën në drejtësi, si dhe në vetë sistemin e drejtësisë në vendin tonë.

Megjithatë ndërtimi i kulturës së integritetit në një shoqëri fillon me edukimin dhe promovimin e integritetit mes të rinjve. Njohuritë, sjelljet dhe aftësitë që të rinjtë mësojnë gjatë shkollimit të tyre në arsimin e mesëm dhe atë të lartë, formësojnë personalitetin e tyre, i cili ndikon drejtpërdrejtë në të ardhmen e një vendi, dhe i ndihmojnë ata të ruajnë integritetin publik i cili është thelbësor në luftën ndaj korrupsionit, apo rritjen e besimit të publikut në çdo institucion shtetëror.

Edukimi për integritetin publik ka të bëjë gjithashtu me frymëzimin nëpërmjet promovimit të shembujve pozitiv të integritetit. Nëpërmjet këtij aktiviteti, KShH synon:

- T'i ofrojë mundësinë të rinjve të Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës, të realizojnë një diskutim të hapur me përfaqësues të fushave të ndryshme, të cilët promovojnë vlera të integritetit, duke përfshirë këtu edhe profesorë të Universitetit, të cilët nëpërmjet një përzgjedhjeje nga vetë studentët, cilësohen si shembujt më të mirë të cilët promovojnë integritetin akademik;
- Të informojë studentë mbi mënyrat e raportimit të korrupsionit, si një mundësi për të promovuar mekanizmat të cilat bëjnë të mundur ruajtjen e integritetit në një shoqëri.

**Target grupi:** 15 studentë nga disa fakultete të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (synohet drejt grupimeve mikse të studentëve)

### Rezultatet e pritshme:

- Promovimi i shembujve pozitivë të integritetit
- Ofrimi i edukimit ligjor mbi rëndësinë e integritetit në sistemin e drejtësisë dhe mundësitë për të raportuar korrupsionin



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## FORUM I HAPUR

***“ Promovimi i vlerave të integritetit me të rinjtë “***

**Draft- Agjenda**

**Data 12 Dhjetor 2022**

**Vendi i realizimit të eventit: Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës**

**Moderator: Lutfi Dervishi**

---

09:30-10:00	<b>Regjistrimi i pjesëmarrësve &amp; Pushim kafeje</b>
10:00-10:10	<b>Fjala e mirëseardhjes</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Z. Kujtim Çashku, President i Asamblese së Komitetit Shqiptar të Helsinkit</li><li>- Prof.Asoc.Dr.Eva Taqja (Allushi), Zëvendës Rektore e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës</li></ul>
10:10-10:20	<b>Prezantim i projektit dhe mënyrat e raportimit të korrupsionit, si formë e promovimit të integritetit</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Znj.Servete Çeka, Paraligjore/Koordinatorë Projektësh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit</li><li>- Znj.Enegrída Bënja, Asistente Projektësh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit</li></ul>
10:20-11:20	<b>Diskutim i hapur me studentët mbi vështirësitë e ruajtës së vlerave të integritetit</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Studentët e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës</li><li>- Znj.Vjollca Meçaj, Anëtare e Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Shqiptar të Helsinkit</li><li>- Pedagogu i votuar si model integriteti nga vetë studentët (tbc)</li></ul>
11:20-11:25	<b>Përmbyllja e diskutimeve</b>

---



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania